



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT
(Përfundimtar)**

**PËR
MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL**

ADMINISTRATA E PREFEKTIT TË QARKUT SHKODËR

Tiranë, Dhjetor 2016

RAPORT

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”* dhe në zbatim të planit të mbikëqyrjes, me vendimin nr. 139, datë 30.12.2015, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër u realizua sipas Programit të Mbikëqyrjes nr. 483 prot., datë 12.07.2016, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 483/1 prot., datë 12.07.2016, *“Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër”*, i është njoftuar Prefektit të Qarkut Shkodër.

Institucioni i Prefektit në momentin e mbikëqyrjes funksiononte sipas ligjit nr. 8927, datë 25.07.2002, *“Për prefektin”*, i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar me ligjin nr. 107/2016, *“Për prefektin e qarkut”*). Administrata e Prefektit përfshihet për herë të parë në shërbimin civil me ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Përfshirja e administratës së Prefektit në *“Listën e institucioneve të administratës shtetërore”*, që hyjnë në fushën e shërbimit civil, është parashikuar në mënyrë të shprehur në nenin 4 *“Përkufizime”*, pika 1/a, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar si dhe në lidhjen nr. 1, (me numër rendor 4), që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të gjithë instituteve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i mbikëqyrjes, i përbërë nga inspektorët Matilda Idrizaj dhe Joni Marko, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër.

Me shkresën nr. 483/2, datë 25.10.2016, të Komisionerit, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 20 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Subjekti i mbikëqyruar, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 586/3 prot., datë 18.11.2016, “Dërgohet projektraporti i nënshkruar nga ana jonë (përgjigje e shkresës tuaj nr. 483/2 prot., datë 25.10.2016)”, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës. Konstatohet se nga ana e institucionit, kanë filluar procedurat për të rregulluar ligjshmërinë në rastet e evidentuara me probleme nga ana e grupit të punës. Ky përfundim arrihet duke u bazuar në urdhrin nr. 48, datë 17.11.2018, të Prefektit të Qarkut Shkodër, “Për zbatimin e detyrave të lëna dhe ndreqjen e parregullsive të miratuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër”, e cila është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Me shkresën nr. 483/4, datë 25.10.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundimit të mbikëqyrjes në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyruar.

Me shkresën nr. 483/3, datë 25.10.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundimit të mbikëqyrjes në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje edhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Në këto rrethana, duke u konsideruar e plotësuar kërkesa për zbatimin e procedurës në këtë rast, u hartua dhe raporti përfundimtar i mbikëqyrjes.

Qëllimi i mbikëqyrjes:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për menaxhimin e burimeve njerëzore, Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të mbikëqyruar, Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë së linjës dhe Departamentit të Administratës Publike, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi dhe shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil.
- Paralajmërimin e personave përgjegjës dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Drejtimit e mbikëqyrjes

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Verifikimi i faktit të përfshirjes ose jo të funksionit në shërbimin civil, në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549/1999, *“Statusi i nëpunësit Civil”*, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese, ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklaramentit të statusit të nëpunësit civil;
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e verifikimit dhe deklaramentit të statusit të punësimit të punonjësve (kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.).
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Verifikimin e faktit nëse punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm).
10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).

11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes:

Grupi i mbikëqyrjes, verifikoi dosjen individuale për çdo të punësuar në pozicione të shërbimit civil si dhe çdo dokument tjetër lidhur me çështje të personelit që rregullohen shprehimisht nga ligji për nëpunësin civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim dhe bashkëbisedim me ******, Prefekt i Qarkut Shkodër dhe ******, me detyrë “Sekretar i Përgjithshëm” në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër , si nëpunës përgjegjës për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit.
- Në këtë takim u bisedua dhe u ra dakord, për objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes. Nëpunësi ******, me detyrë “Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse”, u caktua si person kontakti me grupin e punës.
- Grupi i punës verifikoi pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas strukturës dhe organigramës së institucionit.
- Verifikoi dosjet individuale të çdo nëpunësi civil, mënyrën e fillimit të marrëdhënieve financiare, si dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- Verifikoi përshkrimet e punës për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar.
- Kontrollloi të dhënat profesionale të çdo nëpunësi civil, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës, (nivelet e edukimit, fushën kryesore të studimeve, përvojën në punë etj.), për të vlerësuar nëse nëpunësit e punësuar në pozicionet e shërbimit civil, i plotësonin ose jo kërkesat e posaçme për vendin e tyre të punës.
- Verifikoi ligjshmërinë e akteve të deklarimit të statusit të nëpunësit civil të lëshuara nga Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse për institucionet pjesë e administratës Shtetërore.
- Administroi dokumentacionin e kërkuar, ku përfshihen listëprezenca dhe listëpagesat e punonjësve sipas strukturave përkatëse për periudhën Shkurt 2014 dhe për periudhën Qershor 2016.
- Verifikoi materialet që pasqyrojnë planin vjetor të pranimin në shërbimin civil; rastet e plotësimit të vendeve të lira sipas procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; vlerësimet e rezultateve në punë dhe vlerësimet e rezultateve në përfundim të periudhës së provës; si dhe shënimet që shoqërojnë ato, etj.

- Verifikoi procedurën e ndjekur për transferimin e nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, (aktet që materializojnë ngritjen e komisionit të ristrukturimit, aktet individuale të transferimit të nëpunësve civilë, etj.).

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete, të cilët janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e pandarë e këtij projektraporti.

Përmbajtja e Raportit:

I. Si është zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në lidhje me deklarin e statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit

a) Organizimi i pozicioneve të shërbimit civil në administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër.

Nga analiza dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, u konstatua se, në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (në datë 26.02.2014), administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër, funksiononte në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me urdhrin nr. 61, datë 10.04.2006, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Administratës së Prefektit të Qarkut të Shkodër”.

Bazuar në këtë strukturë organizative, në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (në datë 26.02.2014), Administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër kishte gjithsej **32** vende pune, ku:

- **3 pozicione pune janë funksionarë politikë**, (Prefekt + Nënprefekt i Malësisë së Madhe + Nënprefekt i Pukës).
- **20 pozicione pune, konsiderohen pjesë e shërbimit civil**, (1 pozicion me emërtesën “Sekretar i Përgjithshëm” + 4 pozicione me emërtesën “Përgjegjës sektori” + 1 pozicion me emërtesën “Përgjegjës zyre” + 14 pozicione me emërtesën “Specialist”).
- **3 pozicione pune**, i përkasin Zyrës së Gjendjes civile, (këto pozicione janë pjesë e strukturës dhe organikës së miratuar për administratën e prefektit, por të cilat janë funksione të deleguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile – sqaruar në Kreun I, pika iv, “Konstatim”, të raportit)
- **6 pozicione pune kryejnë funksione administrative**, (1 sekretar i prefektit + 4 shofer + 1 punonjës pastrimi).

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar me vendimin nr. 262, datë 25.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës

në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, (që zënë 60% të numrit total të pozicioneve të punës), paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese – **1 pozicion pune**

Në këtë kategori paraqitet pozicioni i punës me emërtesën “Sekretar i Përgjithshëm”, kategoria e pagës III-a.

- Nëpunës civil të kategorisë së ulët drejtuese – **5 pozicione pune**

Në këtë kategori paraqiten 4 pozicione me emërtesën “Përgjegjës Sektori”, kategoria e pagës III-b + 1 pozicion pune me emërtesën “Përgjegjës zyre”, kategoria e pagës IV-a.

- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive - **14 pozicione pune**

Në këtë kategori paraqiten 3 pozicione pune me emërtesën “Inspektor”, kategoria e pagës IV-a dhe 11 pozicione pune me emërtesën “Specialist”, kategoria e pagës IV-b.

Sa më sipër, konstatohet se, struktura dhe organika e miratuar për institucionin e Prefektit ka të parashikuar pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”, si pozicioni më i lartë i raportimit në hierarkinë e shërbimit civil. Klasifikimi i pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë e lartë drejtuese, të mesëm drejtuese, të ulët drejtuese dhe ekzekutive, është parashikuar në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në mbështetje të këtij neni, ka dalë vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, ku në pikën 5, të Kreut II, ka përcaktuar klasat e zbatueshme për secilën kategori të shërbimit civil, si dhe emërtesën e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë.

Vëmë re se, në emërtesat e pozicioneve të punës të renditura për **Kategorinë I - Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues**, (pika 5, kreu II i vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërcituar), emërtesa Sekretar i Përgjithshëm në institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave dhe ministrive të linjës nuk përmendet. Pra, në lidhje me rastin që po diskutojmë, ku administrata e Prefektit është institucion në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk është parashikuar emërtesa e pozicionit “Sekretar i Përgjithshëm”, si nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues.

Gjithashtu, duke parë natyrën e punës, përgjegjësitë dhe detyrat që realizon pozicioni i punës “Sekretar i Përgjithshëm në institucionin e Prefektit”, çmojmë se, nuk mund të barasvlerësohet me pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm” në Këshillin e Ministrave, ministrinë e linjës apo institucionet e pavarura kushtetuese, në kuptim të ligjit, dallim ky që reflektohet edhe në kategorinë e pagës. Rezulton se, në urdhrin nr. 34, datë 06.07.2016 të Prefektit të Qarkut Shkodër, “Për organizimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër”, pozicioni i punës “Sekretar i Përgjithshëm”, është i kategorizuar me nivel page III-a, kategori page, e cila parashikohet për kategorinë e ulët drejtuese, me emërtesën “shef sektori”, “përgjegjës sektori”, ose pozicione të barasvlerëshme me të.

Në momentin e mbikëqyrjes, administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër, funksionon sipas strukturës dhe organikës së miratuar me urdhrin nr. 11, datë 12.01.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Administratës së Prefektit të Qarkut të Shkodër”. (Për shkak të miratimit të kësaj strukture, institucioni ka kaluar në proces ristrukturimi, i cili është trajtuar në vijim të këtij materiali, në pikën VII “Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore lidhur me ristrukturimin, ngritjen e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin si dhe rastet e tjera të transferimit).

Konkluzion:

Për të gjitha sa analizuam më sipër, në këtë rubrikë të raportit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në konkluzionin se:

- Në përmbajtjen e strukturës organizative të institucionit të mbikëqyrrur, evidentohen në mënyrë të qartë, pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, si dhe pozicionet e punës ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil, siç janë: funksionarët politikë dhe punonjësit administrativë.
- Në lidhje me sqarimin e rolit të Sekretarit të Përgjithshëm, në institucionin e Prefektit, njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, duhet të qartësojë kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet ky pozicion, ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikën 5, të Kreut 2, të vendimit nr. 142, datë 13.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Ky proces duhet të materializohet në shënimet përkatëse në formularin e përshkrimit të punës të Sekretarit të Përgjithshëm në institucionin e Prefektit.

b) Punonjës të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil, në datën e shtrirjes së efekteve të ligjit, (në dt. 26.02.2014), procedura e ndjekur për punësim.

Administrata e Prefektit është përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Neni 67, me nëntitull “Statusi i punonjësve dhe nëpunësve aktualë”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikon rregullimin e statusit për nëpunësit dhe punonjësit që në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, kryenin detyra në vende pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil.

Në mënyrë më të shprehur, në pikën 3, 4 dhe 6, të këtij neni përcaktohet se:

- pika 3, “*Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999,*

“Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;

- pika 4, *“Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;*
- pika 6, *“Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.*

Më tej, vendimi nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në pikën 1, të Kreut III, “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunat”, përcakton se:*

“Punonjës ekzistues”, sipas pikës 3 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, që kryejnë funksione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore e komuna, dhe a) janë rekrutuar sipas procedurave të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, por që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil; apo b) janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë nëpunës civilë për shkak të ligjit”.

Ashtu siç e kemi përmendur edhe më sipër, ***në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, (në dt. 26.02.2014), Administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër kishte 20 pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil dhe 3 pozicione pune që i përkisnin Zyrës së Gjendjes Civile, ku gjendja e pozicioneve të punës rezultoi si më poshtë:***

- ✓ 19 pozicione – të plotësuara
- ✓ 1 pozicion - vend vakant
- ✓ 3 pozicione të gjendjes civile të plotësuara

Mbështetur në bazën ligjore të cituar më sipër, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarin e statusit të punësimit, u verifikuan dhe analizuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, përshkrimet e punës, kohën e fillimit të marrëdhënies së punës, organigramën dhe strukturën e institucionit, e cila ka qenë efektive në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, (listëprezencën dhe listëpagesën e muajit Shkurt 2014), si dhe aktet që pasqyrojnë procedurat e rekrutimit për nëpunësit e emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

1. ***** , ishte e punësuar në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, për një periudhë më pak se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 29, datë 30.10.2013).
2. ***** , ishte i punësuar në pozicionin “Specialist i shërbimeve”, në Nënprefektin e Pukës, për një periudhë më pak se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 19, datë 19.02.2014)

3. *****, ishte i punësuar në pozicionin “*Specialist i emergjencave*”, në Nënprefekturën e Pukës, për një periudhë më shumë se një vit. (Emëruar me aktin nr. 14, datë 26.02.2004)
4. *****, ishte e punësuar në pozicionin “*Specialist për gjendjen civile*”, në nënprefekturën e Pukës, për një periudhë për më shumë se një vit. (Filluar marrëdhënia e punësimit me kontratë individuale me nr. 560 prot, datë 29.03.2011)
5. *****, ishte e punësuar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe funksioneve të Deleguara*”, për një periudhë për më shumë se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 30/1, datë 29.09.2006)
6. *****, ishte e punësuar në pozicionin “*Specialist në Sektorin Juridik dhe Funksioneve të Deleguara*”, për një periudhë më shumë se një vit. (Filluar marrëdhënia e punësimit me kontratë individuale me nr. 744, datë 12.04.2012)
7. *****, ishte i punësuar në pozicionin “*Specialist i rendit dhe i emergjencave civile*”, në Sektorin Juridik dhe Funksioneve të Deleguara, për një periudhë për më shumë se një vit. (Filluar marrëdhënia e punësimit me kontratë individuale me nr. 660 prot., datë 29.03.2011)
8. *****, ishte e punësuar në pozicionin “*Specialist i shërbimeve të deleguara*”, në Sektorin Juridik dhe Funksioneve të Deleguara, për një periudhë më pak se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 46, datë 20.11.2013)
9. *****, ishte i punësuar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Kompetencave Vendore*”, për një periudhë për më shumë se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 68/1, datë 05.08.2010)
10. *****, ishte e punësuar në pozicionin “*Specialist për turizmin dhe territorin*”, në Sektorin e Kompetencave Vendore, për një periudhë për më pak se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 43, datë 15.11.2013)
11. *****, ishte e punësuar në pozicionin “*Specialist i shërbimeve publike*”, në Sektorin e Kompetencave Vendore, për një periudhë për më pak se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 5, datë 21.01.2014)
12. *****, ishte e punësuar në pozicionin “*Specialist koordinimi dhe zhvillimi*”, në Sektorin e Kompetencave Vendore, për një periudhë për më shumë se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 19, datë 16.05.2008)
13. *****, ishte e punësuar në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile*”, për një periudhë për më shumë se një vit. (Emëruar me Urdhrin e Brendshëm nr. 18, datë 16.05.2008)

14. *****, ishte i punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm”, për një periudhë për më shumë se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 67, datë 01.12.2006)
15. *****, ishte e punësuar në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, për një periudhë për më tepër se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 25/1, datë 01.12.2006)
16. *****, ishte e punësuar në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, për një periudhë për më tepër se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 5, datë 21.01.2014, “Për lëvizje paralele”, por marrëdhëniet financiare në këtë institucion kanë filluar në datën 01.09.2004)
17. *****, ishte i punësuar në pozicionin “Inspektor i komanduar”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, për një periudhë për më tepër se një vit. (Filluar marrëdhënia e punësimit me kontratë individuale më datë 03.06.2002)
18. *****, ishte e punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme”, për një periudhë për më pak se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 42, datë 15.11.2013)
19. *****, ishte e punësuar në pozicionin “Specialist i bashkëpunimit dhe marrëdhënieve me publikun”, në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, për një periudhë për më shumë se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 2, datë 18.02.2013)
20. *****, ishte i punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Administrimit Financiar”, për një periudhë për më shumë se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 46, datë 20.06.2007)
21. *****, ishte e punësuar në pozicionin “Specialist”, në Zyrën e Administrimit Financiar, për një periudhë për më pak se një vit. (Emëruar me Urdhrin nr. 40, datë 15.11.2013)
22. Vend vakant, - pozicioni “Specialist i Shërbimeve dhe emergjencave civile”, në Nënprefekturën e Malësisë së Madhe (Në këtë pozicion pune ka qënë i emëruar *****, marrëdhënia e punësimit për të cilin është përfunduar me aktin nr. 22, datë 27.02.2014)
23. Vend vakant- pozicioni “Specialist i gjendjes civile”, në Nënprefekturën e Malësisë së Madhe

Në përmbajtjen e ligjit të posaçëm, në bazë të të cilit funksiononte prefekti dhe administrata e tij, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk parashikohej ndonjë procedurë pranimi konkurruese për punonjësit e punësuar në administratën e këtij institucioni. Më konkretisht, ligji nr. 8927, datë 25.7.2002, “Për prefektin”, i ndryshuar, në

nenin 19, parashikonte se, “*Prefekti në përputhje me strukturën administrative të miratuar, ... emëron dhe largon, sipas procedurave të përcaktuara në ligj, punonjësit e vet të administratës ...*”.

Në këto kushte, duke qenë se ligji i posaçëm, nuk parashikonte ndonjë procedurë konkurruese rekrutimi, deri në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, mënyra e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, zhvillimi i karrierës, garantimi i të drejtave dhe përcaktimi i detyrimeve për punonjësit e administratës së prefektit, janë rregulluar me ligjin nr. 7661, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Me përfshirjen e administratës së Prefektit në shërbimin civil, në referencë të neneve 4/1. a, 4/1. f dhe 20, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”; vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” dhe vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, emërimi i nëpunësve civilë në administratën e Prefektit, nuk është më kompetencë e Prefektit, pasi për administratën shtetërore, emërimet në shërbimin civil, realizohen nga Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet një procedure konkurrimi të hapur.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin e Prefektit, u konstatua se, ky ndryshim kompetencash nuk ishte pasqyruar në ligjin nr. 8927, datë 25.07.2002, “*Për prefektin*”, i ndryshuar. Për këtë arsye në projektraport, ndaj njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, u la si detyrë marrja e masave për materializimin e ndryshimeve përkatëse në ligjin “*Për prefektin*”, në lidhje me kompetencën e emërimit dhe të përfundimit të marrëdhënies së punës për nëpunësit civil në administratën e Prefektit.

Ndërkohë, gjatë procesit të mbikëqyrjes, në momentin e përgatitjes së raportit përfundimtar, u konstatua se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 107/2016, “*Për prefektin e qarkut*”, i cili tashmë ka hyrë në fuqi. Në nenin 21, pika 4, të këtij ligji është parashikuar se:

- “*Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të administratës së prefektit të qarkut rregullohen, në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil*”.

Konkluzion: Në këto kushte, Komisioneri vlerëson si të përmbushur detyrën e lënë në projektraport (*ndryshime të cilat janë pasqyruar në nenin 21, pika 4, të ligjit të sipërcituar*) dhe për këto arsye kjo detyrë nuk do të pasqyrohet në vendimin e paralajmërimit.

- c) ***Procedura e deklarimit të statusit të punësimit, për nëpunësit dhe punonjësit, që kryenin funksione në shërbimin civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.***

Bazuar në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, neni 4, shkronja “f”, Departamenti i Administratës Publike, paraqitet si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur. Ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij e ngarkojnë

njësine përgjegjëse (*DAP-in*), me disa detyra dhe përgjegjësi, në kuadër të garantimit të një shërbimi civil të qëndrueshëm.

Një nga detyrat që ligji i ngarkon njësisë përgjegjëse, është deklarimi i statusit të punësimit, për të gjithë nëpunësit dhe punonjësit të cilët në datën e shtrirjes së efekteve të ligjit, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil.

Më konkretisht, pika 6, e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, përcakton se, "*Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit*".

Më tej, në mbështetje të pikës 8, të nenit 67, të këtij ligji, është miratuar vendimi nr. 116, datë 05.03.2014 i Këshillit të Ministrave, "*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në përmbajtjen e të cilit janë përcaktuar procedurat e hollësishme, që duhet të kryejë njësia përgjegjëse, për të realizuar deklarinin e statusit të punësimit për punonjësit dhe nëpunësit aktualë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Në zbatim të akteve rregullative si më sipër, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë institucionit të mbikëqyrur, (*Spektori i Shërbimeve të Brendshme*), pasi ka evidentuar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil i ka dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, (*që në këtë rast paraqitet si institucion qendror, nga i cili varet institucioni i mbikëqyrur*), listën e plotë të punonjësve të administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër, si dhe dosjen përkatëse, përfshirë aktin e emërimit, kohëzgjatjen e periudhës së punësimit, dokumentacionin lidhur me procedurën e marrjes në punë si dhe dokumentet personale të punonjësve. Më tej, procedura ka vijuar me dërgimin e dokumentacionit pranë njësisë përgjegjëse.

Departamenti i Administratës Publike, pas marrjes së dokumentacionit të mësipërm për çdo të punësuar në pozicione të shërbimit civil, ka verifikuar periudhën e punësimit, nëse ishte më shumë se një vit apo më pak se një vit, si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe kërkesave të posaçme për vendin e punës.

Në përfundim të këtyre verifikimeve, **në datën 30.10.2014**, për institucionin e mbikëqyrur, ka përfunduar procedura e deklarinimit të statusit të punësimit. (*Me shkresën nr. 3285 prot., datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, aktet e deklarinimit i janë përcjellë drejtuesit të institucionit të mbikëqyrur dhe për dijeni edhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme*).

Gjendja e deklarinimit të statusit të punësimit në administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër, për 20 pozicione pune pjesë e shërbimit civil dhe për 3 pozicionet e gjendjes civile, në të cilat kanë qenë punonjës të emëruar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, paraqitet si më poshtë:

- **11 punonjës**, kanë qenë punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit, me statusin e punësimit "*Nëpunës civil*".

- **7 punonjës**, kanë qenë punonjës ekzistues të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më pak se 1 vit, me statusin e punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.
- **1 punonjës**, është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit për shkak se punonjësi nuk dispononte nivelin arsimor sipas kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme të pozicionit të punës në të cilin ka qenë i punësuar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit.
- **1 punonjës**, nuk i është realizuar procedura e deklarimit të statusit të punësimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit, para momentit të kryerjes së kësaj procedure nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike. (*Rasti i ******, i emëruar në pozicionin “*Specialist i shërbimeve dhe emergjencave civile*”, në Nënprefekturën e Malësisë së Madhe, për të cilin marrëdhënia e punësimit është ndërprerë me aktin nr. 22, datë 27.02.2014).
- **2 punonjës**, është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit, për shkak se emërimi i tyre është bërë pa procedurë konkurrimi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Procedura e deklarimit të statusit të punësimit është kryer dhe për 3 (tre) pozicionet e Zyrës së Gjendjes Civile, të cilat janë si më poshtë:

- **2 punonjës** kanë qenë punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit, me statusin e punësimit “*Nëpunës civil*”.
- **1 punonjës**, nuk i është bërë deklarimi i statusit të punësimit nga Departamenti i Administratës Publike për shkak se emërimi i tij është bërë pa procedurë konkurrimi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Më poshtë po i analizojmë me hollësi rastet:

i. Punonjës aktualë të deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil”:

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës pasi verifikoi dokumentacionin e vënë në dispozicion, për **11 punonjësit** e deklaruar me statusin e punësimit “*Nëpunës civil*” vëren se:

- Procedurat e deklarimit të statusit të punësimit “*Nëpunës civil*”, për punonjësit ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , *Geti* ***** , ***** , ***** , ***** dhe ***** , janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Nga këqyrja dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit, nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionet përkatëse të punës dhe momentit të fillimit të marrëdhënies financiare, rezulton e vërtetuar se, në të gjitha këto raste, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, **kanë pasur më shumë se një vit vjetërsi** në detyrën që mbanin në datën 26.02.2014. Për këtë kategori nëpunësish, me të drejtë njësia përgjegjëse (*DAP*), ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si “*Nëpunës civil*”, nëpërmjet vendimeve përkatëse të nxjerra, në muajin Tetor 2014.

- Konstatohet se për të gjithë punonjësit e këtij grupi, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, marrëdhënia e punës me institucionin vazhdon, duke ruajtur të njëjtin status por jo të njëjtin vend pune, *(rastet e transferimit si rrjedhojë e ristrukturimit të institucionit janë trajtuar me hollësi në vijim të materialit në pikën VII, “Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin si dhe rastet e tjera të transferimit”)*.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, në gjithë rastet e përmendura më sipër, njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, ka zbatuar drejt ligjin në lidhje me deklarin e statusit të punësimit si nëpunës civilë, pasi ata i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

ii. **Punonjës aktualë të deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për **7 punonjësit** e deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”, grupi i punës vëren se:

- Procedurat e deklarin të statusit të punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”, për punonjësit *****, *****, *****, *****, *****, *****, dhe *****, janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Nga këqyrja dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit, nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionet përkatëse të punës dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton e vërtetuar se, në të gjitha këto raste, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, konkretisht në datën 26.02.2014, kanë pasur më pak se një vit vjetërsi pune në pozicionet në të cilat kanë qenë të emëruar. Për këtë kategori nëpunësish, me të drejtë njësia përgjegjëse (DAP), ka nxjerrë aktin e deklarin të statusit të punësimit si “Nëpunës civilë në periudhë prove”, nëpërmjet vendimeve përkatëse të nxjerra, në muajin Tetor 2014.
- Konstatohet se për të gjithë punonjësit e këtij grupi, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, marrëdhënia e punës me institucionin vazhdon, duke ruajtur të njëjtin status por jo të njëjtin vend pune, *(rastet e transferimit si rrjedhojë e ristrukturimit të institucionit janë trajtuar me hollësi në vijim të materialit në pikën VII, “Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin si dhe rastet e tjera të transferimit”)*

Konkluzion: Edhe për këto raste, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, ka vepruar drejt në lidhje me deklarin e statusit të punësimit si “Nëpunës civilë në periudhë prove”, pasi ata i

përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

iii. Refuzim i deklaramit të statusit të punësimit për punonjës aktualë në strukturën e muajit Shkurt 2014.

Gjatë procesit të verifikimit, grupi i punës konstatoi se në **1** rast, për punonjësin *****, i emëruar në pozicionin “*Specialist i emergjencave civile*”, në Nënprefekturën e Pukës, nga njësia përgjegjëse është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit.

Punonjësi ***** ka filluar punë në Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër me aktin nr. 14, datë 26.02.2004, në pozicionin “*Specialist i emergjencave civile*”, në Nënprefekturën e Pukës, pozicion në të cilin ka qenë dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Departamenti i Administratës Publike, si njësia përgjegjëse, me shkresën nr. 3285 prot, datë 30.10.2014, “*Verifikim i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktual*”, ka refuzuar të nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për këtë punonjës me arsyetimin se nuk zotëron diplomë të arsimit të lartë. Pozicioni i punës, në të cilin ka qenë i emëruar ky punonjës, klasifikohet si pozicion i kategorisë ekzekutive dhe në përputhje me Lidhjen nr. 2, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, ndryshuar me vendimin nr. 262, datë 25.03.2015, të Këshillit të Ministrave, ndër kërkesat e posaçme të këtij pozicioni është diplomë “*Bachelor*”. Nga këqyrja e dosjes personale rezulton se ky punonjës nuk zotëronte asnjë diplomë universitare, duke mos plotësuar kriteret e posaçme të pozicionit të punës.

Në kuadër të përcaktimeve ligjore të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikës 7, Kreut III, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.”, i ndryshuar, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Administratës së Prefektit Shkodër me urdhrin nr. 16, datë 25.03.2016, “*Lirim nga detyra*” ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies të punësimit për këtë punonjës.

Konkluzion: Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Lidhjes nr. 2, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, duke refuzuar deklarimin e statusit të punësimit për punonjësin *****, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të posaçme të pozicionit të punës “*Specialist i emergjencave civile*”, në Nënprefekturën e Pukës. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, me urdhrin nr. 16, datë 25.03.2016, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës.

iv. 2 raste të refuzimit të deklaramit të statusit të punësimit për punonjës të emëruar pas hyrjes në fuqi të ligjit, pa procedurë të hapur konkurrimi.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, Departamenti i Administratës Publike ka dërguar me shkresën nr. 3285, datë 30.10.2014, praktikën për deklaramin e statusit të punësimit të punonjësve aktualë. Mbështetur në këtë praktikë, DAP ka marrë në shqyrtim rastin e punonjësve ***** dhe ***** , duke refuzuar deklaramin e statusit të punësimit, si më poshtë:

Për punonjësin *****

- Ka filluar punë në Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër me urdhrin nr. 24, datë 03.03.2014, të Prefektit, në pozicionin “*Specialist i shërbimeve dhe emergjencave civile*”, në Nënprefekturën e Malësisë së Madhe.
- Më pas me aktin nr. 54, datë 22.04.2014, është vendosur lirimi i tij nga detyra si “*Specialist i emergjencave civile*” dhe emërimi i tij në pozicionin “*Specialist i gjendjes civile*”, në Nënprefekturën e Malësisë së Madhe.
- Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 3285, datë 30.10.2014, “*Verifikim i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktual*”, ka vendosur refuzimin e deklaramit të statusit të punësimit, pasi urdhri i emërimit në detyrë është bërë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pa procedurë konkurrimi në shërbimin civil. Sipas aktit të nxjerrë nga DAP, refuzimi i deklaramit të statusit të punësimit për këtë punonjës është bërë për pozicionin “*Specialist i gjendjes civile*”.
- Për punonjësin ***** , njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore nuk ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit, pasi sipas listëprezencës të muajit Qershor 2016, ky punonjës rezulton të kryejë detyrën në pozicionin “*Specialist i gjendjes civile*”, në Nënprefekturën e Malësisë së Madhe.

Për punonjësen *****

- Ka filluar marrëdhënien e punësimit në Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër me urdhrin nr. 41, datë 21.03.2014, të Prefektit, në pozicionin “*Specialist i gjendjes civile*”, në Nënprefekturën e Malësisë së Madhe.
- Më pas me aktin nr. 54, datë 22.04.2014, është vendosur lirimi i saj nga detyra si “*Specialist i gjendjes civile*” dhe emërimi i saj në pozicionin “*Specialist i shërbimeve dhe emergjencave civile*”, në Nënprefekturën e Malësisë së Madhe.
- Në kuadër të deklaramit të statusit të punësimit, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me shkresën nr. 3285, datë 30.10.2014, “*Verifikim i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktual*”, ka vendosur refuzimin e deklaramit të statusit të punësimit për këtë punonjës, pasi urdhri i emërimit në detyrë është bërë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pa procedurë pranimit në shërbimin civil. Refuzimi i deklaramit të statusit të punësimit për këtë punonjës është bërë për pozicionin “*Specialist i shërbimeve dhe emergjencave civile*”.
- Si rezultat i refuzimit të deklaramit të statusit të punësimit, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, të Administratës së Prefektit Shkodër, me urdhrin nr. 15, datë

25.03.2016, “Lirim nga detyra”, ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit për punonjësen *****.

Në kuptim të neneve 20, 22 dhe 23, të ligjit të mësipërm dhe Kreut II, të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për Nëpunësit Civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese” (akt normativ i cili ka qenë në fuqi në momentin e procedurës së deklarimit të statusit), emërimi në pozicionet e nivelit ekzekutiv bëhet nëpërmjet një procedure pranimit të hapur, e cila organizohet nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.

Mosrespektimi i kësaj procedure nga Administrata e Prefektit Shkodër, përcakton se aktet e emërimit për punonjësit e mësipërm në pozicionet e shërbimit civil, janë akte absolutisht të pavlefshme dhe se këta punonjës nuk mund të gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për punonjësen *****, akti e emërimit, ka dalë në kundërshtim me ligjin, pasi për çdo marrëdhënie të re pune që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Si rrjedhim emërimi i kësaj punonjëse në pozicionin e mësipërm është absolutisht i pavlefshëm.

Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, me të drejtë ka refuzuar deklarimin e statusit të punësimit për këtë punonjëse.

Me të drejtë, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër, në kuptim të dispozitave të mësipërme ligjore ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit për punonjësen *****, për shkak të ligjit, edhe pse ndërprerja nuk është bërë në mënyrë të menjëhershme pas përfundimit të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit (rast i trajtuar në Kreun II, si dhe në Kreun VII, të raportit).

Në rastin e punonjësit ***** , konstatohet se ai në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka qenë i emëruar në një pozicion të shërbimit civil, por rezulton se kjo marrëdhënie ka përfunduar para nisjes së procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, për shkak se me aktin nr. 54, datë 22.04.2014, ky punonjës është emëruar në pozicionin e punës “Specialist i zyrës së gjendjes civile”, për Rrethin Pukë, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke refuzuar deklarimin e statusit të punësimit për punonjësin ***** , për pozicionin “Specialist i gjendjes civile”. Pozicionet e punës të gjendjes civile, nuk përfshihen në shërbimin civil, pasi konsiderohen si funksione të deleguara (rast i cili trajtohet më hollësisht në rubrikën

në vijim) dhe si rrjedhim emërimi i punonjësve në këto pozicione nuk kërkon respektimin e procedurave të përcaktuara në nenet 22 dhe 25, të ligjit të posaçëm të shërbimit civil.

Konstatim:

Gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, grupi i punës konstatoi se njësia përgjegjëse ka përfshirë në procedurat e deklaramit të statusit të punësimit dhe punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile.

Konkretisht, u konstatua se, njësia përgjegjëse (DAP), ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për 2 (dy) punonjës, të cilët në momentin e zhvillimit të procedurës së deklaramit të statusit të punësimit, ushtronin detyrën në pozicionet e Zyrës së Gjendjes Civile. Bëhet fjalë për punonjëse *****, për të cilën me aktin nr. 3285/6, datë 30.10.2014, është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile” dhe për punonjësen *****, për të cilën me aktin nr. 3285/11, datë 30.10.2014, është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin “Specialist për gjendjen civile”, në Nënprefekturën e Pukës. Njëkohësisht rezultoi se njësia përgjegjëse me aktin nr. 3285, datë 30.10.2014, ka refuzuar deklaramin e statusit të punësimit për punonjësin *****, për shkak se emërimin e tij është bërë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pa procedurë të hapur konkurrimi. (rast i trajtuar më sipër në pikën “iv” të raportit).

Nga verifikimi dhe shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe i praktikës së Komisionerit për raste të ngjashme vërejmë se:

Në strukturën dhe organikën e institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, të miratuar me urdhrin nr. 61, datë 10.04.2006, të Kryeministrit, strukturë e cila ishte në fuqi edhe në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Zyra e Gjendjes Civile dhe 3 punonjësit e saj janë pjesë e organikës dhe e numrit të përgjithshëm të punonjësve të institucionit të Prefektit. Sjellim në vëmendje se kjo strukturë e institucionit të Prefektit ka qenë në fuqi e pandryshuar, deri në daljen e urdhrin nr. 11, datë 12.01.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut të Shkodër”, strukturë e cila ka filluar të zbatohet në datën 06.07.2016.

Ndërkohë që struktura e vjetër e institucionit të Prefektit ishte në fuqi, ka dalë vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1299, datë 16.12.2009, “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në Bashki/Njësi Bashkiake/Komuna dhe në Degët e Qarqeve”, i cili ka miratuar strukturën e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Në pikën 3 të këtij akti nënligjor, është përcaktuar se numri i nëpunësve të miratuar për institucionin e Prefektit, si nëpunës të gjendjes civile në degët e qarkut, i kalon numrit të përgjithshëm të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile. Më tej, në pasqyrën nr. 1, bashkëlidhur vendimit të qeverisë, vërehet se zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut kanë varësi direkte nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme.

Pra zyrat e gjendjes civile në Degët e Qarkut, të vendosura pranë institucionit të Prefektit, janë pjesë e strukturës së shërbimit të gjendjes civile, me varësi direkte nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Ky rregullim është reflektuar në strukturën dhe organikën e re, të miratuar me urdhrin nr. 11, datë 12.1.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut të Shkodër”, ku rezulton se zyra e gjendjes civile nuk është e përfshirë në strukturën dhe organikën e institucionit të Prefektit.

Por nga ana tjetër, konstatohet se, në procedurat e kryera për sistemimin e nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të institucionit, nëpunësit e Zyrës së Gjendjes Civile janë trajtuar si nëpunës civilë, pasi janë deklaruar më parë si të tillë, ashtu si është parashtruar në këtë rubrikë të raportit.

Një fakt i tillë konstatohet në materialin e Komisionit të Ristrukturimit “Propozim për transferimin e përhershëm të punonjësve të institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër”, drejtuar DAP-it, në përmbajtje të të cilit punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile janë trajtuar si funksione të deleguara, por nga ana tjetër, Departamenti i Administratës Publike në shkresën e tij nr. 517/4, datë 12.04.2016, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër”, drejtuar institucionit, **i ka trajtuar këto pozicione si pjesë e shërbimit civil, duke nxjerrë dhe aktet individuale të transferimit për punonjësit e emëruar në këto pozicione.**

Nisur nga praktika e Komisionerit, gjatë mbikëqyrjes në disa institucione të tjera të administratës publike rezulton se, me shkresën nr. 1212/2 prot., datë 27.05.2014, “Kthim përgjigje”, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamenti i Administratës Publike, është shprehur në lidhje me pozicionin e nëpunësve të gjendjes civile në raport me shërbimin civil, pasi këtë detyrim e ka përcaktuar Komisioneri në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Më konkretisht, në përmbajtjen e kësaj shkrese, Departamenti i Administratës Publike, shprehet se:

“... Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, nëpunësit në pozicione të ofrimit direkt të shërbimeve për publikun, janë të përjashtuar nga fusha e veprimit të këtij ligji.

Për sa më sipër, **nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në degët e qarkut, bashkitë, njësitë bashkiake apo komunat, nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil**”.

Ndodhur në këto kushte, për rivlerësimin e kësaj situatë, nisur nga detyrat specifike që realizojnë pozicionet e punës së Gjendjes Civile në institucionin e Prefektit, në projektraport, ndaj njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, u la si detyrë unifikimi i qëndrimit në lidhje me pozicionet e gjendjes civile në të gjithë administratën publike.

Ndërkohë, rezulton se Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 6604/1, datë 25.11.2016, “Shërbimi i gjendjes civile në prefektura”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, sqaron statusin e nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në degët e qarkut apo

bashki, duke konkluduar se këto pozicione, për shkak të funksionit që ata kryejnë nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konkretisht në përmbajtje të kësaj shkrese, Departamenti i Administratës Publike sqaron se:

“Në mbështetje të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, neni 60, citohet se: “Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Ai plotëson, përditëson dhe administron Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe kryen shërbime të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shërbimi i gjendjes civile u jep të dhëna marrësve, sipas përcaktimeve të ligjit dhe akteve nënligjore, si dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Bazuar në funksionin që ligji “Për gjendjen civile” i ka dhënë, shërbimi i gjendjes civile në degët e qarkut dhe bashki përfshihet në njësitë publike direkte të shërbimit, të cilat, sipas nenit 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përjashtohen nga fusha e veprimit të këtij ligji”.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se procedura e kryer nga Departamenti i Administratës Publike, për deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile, është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi pozicionet e gjendjes civile nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Në kuptim të nenit 108, pika “a”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktet e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit e gjendjes civile janë akte absolutisht të pavlefshme dhe në kuptim të nenit 110, pika 1, të po këtij ligji, këto akte nuk sjellin asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse janë konstatuar si të tilla apo jo.

Për rregullimin e paligjshmërisë së këtyre akteve administrative, në kuptim të nenit 111 dhe 113, pika 1, të Kodit të Procedurës Administrative, Departamenti i Administratës Publike duhet të vendosë anulimin e akteve të deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit e gjendjes civile, si më poshtë:

- 1- Anulimin e aktit nr. 3285/6, datë 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit” për punonjësen *****, me të cilën është deklaruar “Nëpunës civil”;
- 2- Anulimin e aktit nr. 3285/1, datë 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, për punonjësen *****, me të cilën është deklaruar “Nëpunës civil”;
- 3- Anulimin e pjeshëm të aktit nr. 3285, datë 30.10.2014, “Verifikim i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktual”, për pjesën në të cilën refuzohet deklarimi i statusit të punësimit për punonjësin *****.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, me të drejtë njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, nuk ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit për

punonjës in *****, i cili rezulton të ushtrrojë aktualisht detyrën e tij në pozicionin “Specialist i zyrës së gjendjes civile”, për Rrethin Pukë.

v. Procesi i deklarimit të statusit të punësimit në raport me afatet ligjore:

Vendimi nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (ndryshuar me vendimin nr. 532, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave; ndryshuar me vendimin nr. 627, dt. 24.09.2014 të Këshillit të Ministrave), ka parashikuar procedurat e hollësishme që duhet të kryejë njësia përgjegjëse për të realizuar deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit dhe nëpunësit aktualë si dhe afatin brenda të cilit duhet të përfundojë i gjithë ky proces. Në Kreun IV, të vendimit si më sipër, është përcaktuar se “Procedura e deklarimit të statusit të punësimit përfundon jo më vonë se 120 (njëqind e njëzetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. ... Në çdo rast, shtyrja e afatit nuk mund të jetë më vonë se data 30 tetor 2014 ...”.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes Komisioneri konstaton se, Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur, i ka përfunduar procedurat e deklarimit të statusit të punësimit **në datën 30.10.2014**, pra brenda afatit të vendosur në vendimin e Këshillit të Ministrave.

(Të dhënat që pasqyrojnë realizimin e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, siç janë: akti për fillimin e marrëdhënieve të punës në administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër; akti i deklarimit të statusit të punësimit “Nëpunës civil” apo “Nëpunës civil në periudhë prove”, si dhe të dhënat lidhur me përmbushjen e detyrimeve të periudhës së provës, janë të pasqyruara në mënyrë analitike në **Aneksin nr. 1**, “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (data 26.02.2014”).

II. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, u verifikuan përshkrimet e punës, për të vlerësuar nëse janë respektuar rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, akte të cilat kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Këto akte nënligjore, në përmbajtje të tyre kanë përcaktuar rastet kur një institucion pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojë përshkrimet e punës, procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen si dhe nëpunësit përgjegjës për këtë proces.

Më konkretisht, vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, në Kreun IV, pika 14, “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës”, përcakton se:

“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.

Përshkrimi i punës hartohet nga analisti i punës, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës dhe në rastet kur analisti i punës mungon në strukturën e institucionit, për të cilin ka lindur nevoja e hartimit të përshkrimeve të punës, ky proces realizohet nga drejtuesi i njësisë organizative për menaxhimin e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës.

Departamenti i Administratës Publike, jep mendim lidhur me përshkrimet e punës nëse janë të hartuara në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar dhe më pas përshkrimet e punës i dërgohen për miratim Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së linjës, i cili finalizon këtë proces duke nënshkruar përshkrimet e punës në ndarjen përkatëse.

Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, për periudhën objekt kontrolli (*Shkurt 2014 – Qershor 2016*), evidentojmë dy momente që kanë diktuar nevojën e hartimit të përshkrimeve të reja të punës.

Së pari, fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe përfshirja e Administratës së Prefektit në shërbimin civil.

Me fillimin e efekteve të legjislacionit të ri të shërbimit civil, (*ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij*), administrata e prefektit, për shkak të përfshirjes në listën e institucioneve pjesë të shërbimit civil, duhet të hartonte përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil.

Vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, në Kreun VI, “Dispozita transitore”, pika 40, ka parashikuar detyrimin e të gjitha institucioneve pjesë të shërbimit civil, që të përfundojnë hartimin e përshkrimit të punës, deri në datën 1 Korrik 2014.

Së dyti, ndryshimi i mënyrës së organizimit të institucionit në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së institucionit, në bazë të urdhrit nr. 11, datë 12.02.2016, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër”, që është dhe struktura në fuqi, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes.

Nga procesi i verifikimit në institucionin e mbikëqyrur, u konstatua se:

- Në lidhje me momentin e parë, fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* dhe përfshirjes së administratës së prefektit në shërbimin civil, institucioni i mbikëqyrur, për hartimin e përshkrimeve të punës për pozicionet e punës sipas strukturës e cila ka qenë në fuqi më datë 26.02.2014, nuk disponon dokumente shkresore të cilat vërtetojnë respektimin e procedurës së përcaktuar në ligjin e posaçëm për shërbimin civil si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, për hartimin e përshkrimeve të punës. *(Korrespondenca me Departamentin e Administratës Publike është bërë në mënyrë elektronike, por për shkak të problemeve teknike këto materiale nuk janë në formatin shkresor)*. Përshkrimet e punës rezultojnë të jenë të depozituara në dosjet personale të nëpunësve civile dhe të firmosur nga nëpunësi civil i pozicionit respektiv, eprori direkt dhe nga sekretari i përgjithshëm i institucionit të kontrolluar.
- Në mungesë të analistit të punës dhe në mungesë të Përgjegjësit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të kontrolluar *(pozicion i lirë)*, përshkrimet e punës për pozicionet sipas strukturës së miratuar me urdhrin nr. 11, datë 12.02.2016, të Kryeministrit *“Për miratimin e strukturës dhe pune të organikës së Administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër”* janë hartuar nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, si dhe përgjegjësit e sektorëve.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se përshkrimet e punës janë hartuar vetëm për 19 pozicione të shërbimit civil, ndërkohë që për 2 (dy) pozicionet *“Specialist”*, në Sektorin e Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, përshkrimet e punës figurojnë të mos jenë hartuar. Grupi i punës konstaton se për pozicionet e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (1 Përgjegjës Sektori + 4 Specialist), përshkrimet e punës kanë mangësi, pasi në to nuk janë plotësuar të gjitha rubrikat që përmban formulari standard i përshkrimit të punës.
- Përshkrimet e punës, janë hartuar sipas standardit të miratuar në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, por nuk rezultojnë që të jenë miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- Njëkohësisht, u konstatua se Departamenti i Administratës Publike nuk është shprehur në lidhje me procesin e përshkrimit të pozicioneve të punës për administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër.
- Në Kreun XII *“Nënshkrimi”*, të formularit të përshkrimit të punës, rezulton që në cilësinë e eprorit direkt për të gjithë nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive të jetë shënuar Përgjegjësi i Sektorit ose Prefekti i Qarkut Shkodër, dhe për nëpunësit civil të nivelit të ulët drejtues, në cilësinë e eprorit direkt të jetë pasqyruar Prefekti.

Në nenin 4, pika 1/e, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është përkufizuar kuptimi i termit “Epror direkt”, ku në mënyrë të shprehur kjo dispozitë përcakton se: *Epror direkt* është:

- i)
- ii) Sekretari i përgjithshëm apo nëpunësi në pozicionin ekuivalent me të, për drejtorët e drejtorive dhe drejtuesit e degëve territoriale të institucionit;
- iii) ...;
- iv) *Drejtori i drejtorisë për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të tjera.*

Duke parë organikën në fuqi të institucionit të mbikëqyrur, në këndvështrim të dispozitës së mësipërme, vëmë re se, pozicioni “Drejtor i Drejtorisë” nuk është parashikuar, por nga ana tjetër është parashikuar pozicioni “Sekretar i Përgjithshëm”, për të cilin duhet të përcaktohet kategoria e shërbimit civil ose pozicioni i barasvlershëm me të, pasi ky moment qartëson pozicionin që paraqitet si epror direkt, për të gjithë nëpunësit që janë pjesë e shërbimit civil, të tillë si “përgjegjës sektori” dhe “specialist”.

Për këtë arsye, në ndarjen XIII, të përshkrimit të punës, me nëntitull “Nënshkrimi”, tek “eprori direkt” duhet të nënshkruajë nëpunësi i punësuar në pozicionin që paraqitet si epror direkt, (që në këtë rast do të qartësohet nga njësia përgjegjëse) dhe jo përgjegjësi i sektorit, ndërsa tek “Sekretari i Përgjithshëm”, nënshkruan Sekretari Përgjithshëm i ministrisë së linjës, i cili ka kompetencën për miratimin e përshkrimeve të punës.

Konkluzion: Komisioneri rekomandon Sekretarin e Përgjithshëm të institucionit dhe Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, që në këtë rast paraqitet në rolin e strukturës përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, të ndërmarrë hapat e mëposhtme:

- Të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, dhe lidhjeve bashkëlidhur këtij vendimi. Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen për hartimin e përshkrimeve të punës, nëpunësit përgjegjës për hartimin e këtyre akteve, strukturën përgjegjëse për vlerësimin e bazueshmërisë së tyre në ligjin specifik dhe formatin e miratuar, organin që ka kompetencën për miratimin e tyre, si dhe depozitimin e tyre pranë njësisë përgjegjëse.
- Në kushtet kur, organikës në fuqi i mungon analisti i punës, struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, (Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse), mbështetur në legjislacionin specifik dhe në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm të mbledhë informacionin e nevojshëm për çdo pozicion pune dhe pas një analize të këtij informacioni, të përcaktohen edhe njëherë në mënyrë të qartë detyrat, përgjegjësitë dhe kërkesat e veçanta për çdo pozicion apo grup pozicionesh të shërbimit civil.

- Formati i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil, të jetë sipas lidhjes 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, dhe të ketë të përfshirë të gjithë elementet, siç janë të dhënat për pozicionin e punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës dhe kërkesat e posaçme.
- Në ndarjen “Kërkesat e posaçme”, të plotësohen në mënyrë të qartë kërkesat e posaçme që duhet të plotësojë nëpunësi për: nivelin e arsimit (*niveli i diplomës “Bachelor”*; “*Master Profesional*”; “*Master i Shkencave*” që ai/ajo duhet të zotërojë); profili i arsimit të lartë që duhet të ketë; kualifikimet/trajnimet dhe kërkesa të tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës të shërbimit civil.
- Institucioni i mbikëqyrur t’i kërkojë njësisë përgjegjëse, (DAP), që të japë mendimin lidhur me përshkrimet e punës nëse janë hartuar në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
- Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse, përshkrimet e punës t’i përcillen për miratim Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë së linjës, i cili finalizon këtë proces duke nënshkruar përshkrimet e punës në ndarjen përkatëse, pasi nënshkrimi i formularit të përshkrimit të punës nga ana e tij, nga eprori direkt dhe nëpunësi civil për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, është një detyrim specifik, i parashikuar në pikën 18, 19 dhe 20 të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.
- Në përfundim të procedurave si më sipër, një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike. Kjo për faktin pasi, vetë akti nënligjor, i ka konceptuar këto akte me karakter të qëndrueshëm që hartohen kur krijohen institucione të reja dhe që kushti për t’u ndryshuar është ndryshimi i mënyrës së organizimit të institucionit apo ndryshimi i legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni.

Procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës është një procedurë administrative, kryerja e së cilës kërkon respektimin e rregullave dhe të afateve të vendosura në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar si dhe udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Njësia përgjegjëse dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, në çdo rast, procedurat administrative që kanë lidhje me menaxhimin e shërbimit civil, përveç komunikimit

në mënyrë elektronike duhet t'i administrojnë edhe në mënyrë shkresore. Administrimi në formë shkresore është i domosdoshëm jo vetëm si kërkesë e ligjit por edhe me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës si dhe organet e ngarkuara për të kontrolluar zbatimin e ligjit.

III. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, në të cilin është përcaktuar se, mbikëqyrja përfshin ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, për periudhën kohore nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, e në vijim, grupi i punës verifikoi planifikimin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin 2015 dhe për vitin 2016.

Planifikimi i nevojave për rekrutim në shërbimin civil realizohet duke u bazuar në përcaktimet e nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”. Ky vendim, i cili përcakton në mënyrë të hollësishme procedurën që duhet të ndiqet për hartimin e planit vjetor, në nenin 3 të tij, përcakton se në planifikimin vjetor të pranimi në shërbimin civil, duhet të mbahet parasysh mbushja e moshës së pensionit të nëpunësit civil, parashikimi i vendeve të reja në shërbimin civil dhe ecuria e krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil për arsye të tjera të paparashikuara.

Në bazë të akteve të mbikëqyrura, u konstatua se, për periudhën e mbikëqyrjes, administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër ka përgatitur vetëm planin e nevojave për rekrutim për vitin 2016, i cili i është paraqitur “Sekretarit të Përgjithshëm”, të Ministrisë së Punëve të Brendshme me shkresën nr. 1637 /1, datë 03.11.2015.

Në planifikimin e nevojave për rekrutim për vitin 2016, është paraqitur nevoja për plotësimin e 5 pozicioneve të lira, konkretisht si më poshtë:

- Specialist i Emergjencave Civile në Rrethin Pukë
- Specialist i Emergjencave Civile në Rrethin Malësi e Madhe
- Specialist i Gjendjes Civile në Rrethin Malësi e Madhe
- Specialist në Auditin e Brendshëm (për shkak të daljes në pension)
- Specialist në Zyrën e Administrimit Financiar (për shkak të lejes së lindjes).

Pavarësisht se plani vjetor për vitin 2016, nuk ka më fuqi juridike për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe mos ekzistencës së pozicioneve për të cilat është kërkuar plotësimi i tyre sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe si rrjedhim, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, nuk mund të organizojë procedurën e konkurrimit për këto pozicione, grupi i punës konstaton disa parregullsi, të cilat paraqiten si më poshtë:

- Për pozicionin “Specialist në Zyrën e Administrimit Financiar” është kërkuar plotësimi i saj, për shkak të marrjes së lejes së lindjes së nëpunëses që ka qenë e emëruar në këtë pozicion para momentit të ristrukturimit të institucionit.

Pozicionet e shërbimit civil, të cilat krijohen të lira në mënyrë të përkohshme (*si në rastin e marrjes së lejes së lindjes*), janë pozicione të cilat në kuptim të ligjit nuk mund të përfshihen në planin vjetor të rekrutimit në shërbimin civil. Ligji i posaçëm për shërbimin civil, në nenin 23, pika 3/1, të tij përcakton se plotësimi i vendeve të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme plotësohet nëpërmjet kandidatëve fitues të paemëruar ende, sipas renditjes së tyre në listën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

Në kuptim të Kreut V, pikës 1 dhe 2, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin. Lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku krijohet pozicioni i punës vakant në mënyrë të përkohshme, duhet t’i drejtohet njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, për të njoftuar për pozicionin e punës dhe shkakun e vakancës së saj, procedurë e cila rezulton të mos jetë kryer nga institucioni i kontrolluar.

- Për pozicionet “*Specialist i Emergjencave Civile*”, në Rrethin Pukë dhe për pozicionin “*Specialist i Emergjencave Civile*”, në Rrethin Malësi e Madhe ka kërkuar plotësimin e tyre si pozicione të lira, të krijuara si rrjedhojë e refuzimit të deklaratimit të statusit të punësimit për punonjësit ***** dhe ***** , të cilët kanë qenë të emëruar në këto pozicione.

Nga këqyrja e akteve të administruara gjatë mbikëqyrjes, rezulton një mospërputhje midis planit vjetor të rekrutimit në shërbimin civil dhe listëprezencës e listëpagesës për periudhën e mbikëqyrjes. Pavarësisht se për punonjësit ***** dhe ***** , është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, DAP, këta punonjës kanë vazhduar të ushtrojnë detyrën e tyre në këto pozicione deri në momentin e kryerjes së procedurës së ristrukturimit të institucionit. Një parregullsi e tillë, ka ardhur si pasojë e mos ndërprerjes së marrëdhënieve financiare nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore për këta punonjës, në kuptim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

- Për pozicionin “*Specialist në Auditin e Brendshëm*”, në të cilin ka qenë i emëruar nëpunësi ***** , njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka kërkuar plotësimin e këtij pozicioni për shkak të mbushjes së moshës së pensionit nga ky punonjës.

Në rastin konkret, konstatohet se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka vepruar konform nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” dhe nenit 3, të vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”. Sipas të dhënave të dosjes personale të nëpunësit ***** , i cili në momentin e mbikëqyrjes ushtron detyrën e tij në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, rezulton se ky nëpunës ka mbushur moshën e pensionit më datë 23.07.2016. Për këtë arsye, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka filluar procedurën e ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil për këtë nëpunës.

Konkluzion: Komisioneri, orienton institucionin e mbikëqyrur, që në të ardhmen të tregojë kujdes në përgatitjen e planit të nevojave për rekrutim në shërbimin civil, në koherencë me

ecurinë e krijimit të vendeve vakante në institucion. Në hartimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, institucioni duhet të marrë në konsideratë përcaktimet e nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, pasi procesi i planifikimit vjetor shërben si bazë për plotësimin në kohë të vendeve të lira, e më tej edhe përdorimit me efikasitet të burimeve njerëzore të institucionit.

Për pozicionet e lira, të cilat në kuptim të ligjit krijohen në mënyrë të përkohshme, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, duhet t’i drejtohet njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike për plotësimin e tyre sipas procedurës të përcaktuar në nenin 23, pika 3/1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Kreun V, “Emërimi i përkohshëm”, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” si dhe Kreun IV, “Emërim i përkohshëm”, i vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

Komisioneri vlerëson se, me të drejtë Ministria e Punëve të Brendshme, në shkresën e saj nr.8761/1, datë 13.01.2016, “Mbi planin e nevojave për rekrutim në shërbimin civil për vitin 2016”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike, nuk ka përfshirë në planin vjetor, pozicionin e lirë të krijuar në mënyrë të përkohshme për institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër.

IV. Rastet e rekrutimeve, lëvizjeve paralele, ngritjeve në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rastet e pezullimit nga shërbimi civil si dhe të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirit nga shërbimi civil.

Për periudhën objekt mbikëqyrje, nuk u konstatuan emërimet në pozicionet e shërbimit civil nëpërmjet procedurave të pranimit në shërbimin civil, të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të parashikuara nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Njëkohësisht konstatohet se, për periudhën objekt mbikëqyrje, konkretisht nga muaji Shkurt 2014, deri në momentin e mbikëqyrjes Qershor 2016, për nëpunësit civilë të administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër nuk janë marrë masa pezullimi nga shërbimi civil si dhe nuk ka pasur raste të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.

V. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës.

Nëpunësit civilë që emërohen për herë të parë në shërbimin civil i nënshtrohen një periudhe prove. Afati i periudhës së provës si dhe detyrat që duhet të përmbushë nëpunësi dhe institucioni përgjatë kësaj periudhe dhe në përfundim të saj, janë të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Kreun V të vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të

mesme drejtuese”, (për të gjitha ato procedura që kanë filluar gjatë kohës që ka qenë në fuqi kjo VKM); si dhe në Kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Ndërsa për nëpunësit dhe punonjësit ekzistues, (nëpunësit dhe punonjësit që fillimi i efekteve të ligjit i gjeti në funksione të shërbimit civil) dhe që kishin një periudhë punësimi më të vogël se një vit, në pikën 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është përcaktuar se për ta zbatohet neni 24, i këtij ligji dhe se periudha e provës fillon nga fillimi i efekteve të ligjit.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe të nxjerrë vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të planit të mbikëqyrjes, grupi i punës verifikoi tërësinë e veprimeve të kryera për konfirmimin e nëpunësve civile, të cilët i janë nënshtruar periudhës së provës dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit me institucionin.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, përgjatë vitit 2015 kanë përfunduar periudhën e provës 7 nëpunës (***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , *****). Këta punonjës në momentin e fillimit të efekteve të ligjit e kishin periudhën e punësimit në të njëjtin vend pune, më pak se një vit.

Nga verifikimi i akte që materializojnë procedurën e zbatuar për konfirmimin pas përfundimit të periudhës së provës rezulton se:

Gjatë periudhës së provës, nëpunësit kanë kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe në fund të trajnimit i janë nënshtruar testimit. Bazuar në pikën 2, të Kreut IV, të vendimit nr.138, datë 13.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike dhe trajnimit e nëpunësve civil”, i ndryshuar, trajnimi për periudhën e provës pranë ASPA-s konsiderohet i ndjekur me sukses nëse nëpunësi merr të paktën 50 % të pikëve në testim. Nga verifikimi i vërtetimeve (certifikatave) të lëshuara nga ASPA rezulton se, në testimin përfundimtar Sekretari i Përgjithshëm, i cili sipas ASPA-s klasifikohet në nivelin e mesëm drejtues është vlerësuar “Përfundoi me sukses trajnimit”, ndërsa 1 punonjës i kategorisë së ulët drejtuese dhe 5 nëpunës të kategorisë ekzekutive janë vlerësuar me pikë, ku kanë marrë mbi 50 % të pikëve.

Titullari i institucionit, Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të Kreut V, të vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të

ulët dhe të mesme drejtuese”, (i cili ka qenë ligji i zbatueshëm për procedurat e vlerësimit të periudhës së provës të nisura më datë 26.02.2014), ka caktuar nëpunësin civil më të vjetër të institucionit për të gjithë nëpunësit civilë në periudhë prove.

Nëpunësve iu është bërë vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore. *(Nga aktet e mbikëqyrura, rezulton se për punonjësit ***** , ***** , ***** është dhënë vlerësimin “Shumë mirë” dhe për punonjëset ***** , ***** , ***** është dhënë vlerësimi “Mirë”).*

Në përfundim të periudhës së provës, titullari i institucionit ka finalizuar këtë proces, duke nxjerrë aktet e konfirmimit për 7 nëpunësit civilë, akte të cilat rezultojnë të jenë të depozituara në dosjen personale të nëpunësve.

- Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, struktura është e organizuar në nivel sektori dhe i mungon pozicioni “Drejtori i Drejtorisë”, ndërsa për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, nuk është e qartë kategoria e shërbimit civil ose pozicioni i barasvlershëm me të.

Në momentin që njësia përgjegjëse do të shprehet për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, lidhur me kategorinë e shërbimit civil ose pozicionin e barasvlershëm me të, do të qartësohet pozicioni që paraqitet si epror direkt, për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të shërbimit civil, siç janë pozicionet “përgjegjës sektori” dhe “specialist”.

Vendimet e konfirmimit, pas përfundimit të periudhës së provës, nuk i janë njoftuar Departamentit të Administratës Publike, i cili paraqitet në cilësinë e njësisë përgjegjëse për këtë institucion dhe si organi kompetent për administrimin e Regjistrimit Qendror të Personelit.

Konkluzion: Komisioneri, konstaton se, institucioni i mbikëqyrur ka respektuar kërkesat e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të Kreut V, të vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, (akt i cili ka qenë në fuqi në momentin e kryerjes së kësaj procedure), gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës, për nëpunësit ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** .

Në lidhje me rregullshmërinë e akteve të nxjerra nga Prefekti, për konfirmimin e nëpunësve civilë, pas përfundimit të periudhës së provës, Komisioneri do të shprehet, pasi njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, të bëjë unifikimin e pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm në institucionin e Prefektit, duke përcaktuar rolin e tij në hierarkinë e shërbimit civil në prefektura.

Njëkohësisht, Komisioneri rekomandon njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të Administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër, që për rastet e mundshme të përfundimit të periudhës së provës, vendimet e eprorit direkt duhet t’i njoftohen Departamentit të Administratës

Publike, i cili në kuptim të vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, është kompetent për administrimin e Regjistrit Qendror të Personelit.

(Për nëpunësit që kanë përfunduar periudhën e provës, të dhënat lidhur me: kryerjen e ciklit të trajnimit pranë ASPA-s; vlerësimi i rezultateve individuale në punë; si dhe, akti i konfirmimit si nëpunës civil, janë pasqyruar në **Aneksin nr. 1**, që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij).

VI. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe mënyra e realizimit të procesit nga zyrtarët kompetentë

Vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë është parashikuar në nenin 62, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Kjo dispozitë parashikon se vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që realizohet çdo 6 muaj. Ndërsa në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, periudha e vlerësimit është një vit dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil.

Më tej, në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ndryshuar me vendimin nr. 252, datë 30.03.2016, të Këshillit të Ministrave, janë përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për të vlerësuar nivelin e realizimit të objektivave të vendosura, vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit; detyrat e zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit; nivelet e shkallëzuara të vlerësimit si dhe të drejtat e nëpunësit në rastet kur ai nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, i cili konsiston në zhvillimin e fazës së planifikimit, në të cilën duhet të identifikohen objektivat kryesore të punës dhe sjelljet profesionale që duhet të përmbushë nëpunësi; zhvillimin e fazës së bisedimeve të ndërmjetme për të vlerësuar progresin e nëpunësit që i nënshtrohet vlerësimit; si dhe në vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë, ku zyrtari raportues, bën një vlerësim të përmbledhur në arritjen e objektivave kryesore të punës për nëpunësin që do të vlerësohet.

Gjatë verifikimit u konstatua se, formularët e vlerësimit të punës janë hartuar sipas formatit të miratuar në Lidhjen nr. 2, pjesë e vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ku janë materializuar të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (ndarja A); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (ndarja B); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (ndarja C); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, shpeshësinë e orëve të punës jashtë orarit, kërkesën për këshillim, trajnim dhe ngritjen profesionale (ndarja Ç); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmbledhur i arritjes së objektivave kryesore të punës nga nëpunësit.

Në zbatim të programit të kontrollit, për të gjithë nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes punonin në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, u verifikuan vlerësimet e rezultateve në punë për gjashtëmujorin e parë dhe të dytë të vitit 2015.

Duke pasur parasysh katër nivelet e vlerësimit “shumë mirë”, “mirë”, “kënaqshëm” dhe “jo kënaqshëm”, nga verifikimet e kryera, vlerësimi përfundimtar i tyre, paraqitet si më poshtë:

Tabela: Niveli i vlerësimit të punonjësve të administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër, të deklaruar si nëpunës civil.

Periudha e vlerësimit	Janar – Qershor 2015			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Niveli i vlerësimit përfundimtar				
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	3	8	-	-
Numri i punonjësve të pavlerësuar			-	
Totali			11	

Periudha e vlerësimit	Korrik – Dhjetor 2015			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Niveli i vlerësimit përfundimtar				
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	3	7	-	-
Numri i punonjësve të pavlerësuar			1 (*****)	
Totali			11	

Për të **7 punonjësit**, për të cilët më hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, u lëshua akti i deklarimit të statusit të punësimit si “Nëpunës civil në periudhë prove” dhe për të cilët procedura e konfirmimit përfundoi me nxjerrjen e vendimeve nga eprori direkt më Qershor të 2015, u shqyrtuan vetëm vlerësimet e rezultateve në punë për gjashtëmujorin e dytë Korrik – Dhjetor 2015, e cila pasqyrohet si më poshtë:

Tabela: Niveli i vlerësimit të punonjësve të administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër, të deklaruar si nëpunës civil në periudhë prove.

Periudha e vlerësimit	Korrik – Dhjetor 2015			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Niveli i vlerësimit përfundimtar				
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	2	2	-	1
Numri i punonjësve të pavlerësuar		2 (*****; *****)		
Totali			11	

Duke analizuar përmbajtjen e procesit, në zbatim nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civile”, i ndryshuar, u konstatua se:

- Nga institucioni i mbikëqyrur nuk është kryer procedura e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik – Dhjetor 2015 për nëpunësit ***** , i cili në momentin

e vlerësimit ka qenë i emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Kompetencave Vendore” dhe *****, i cili në momentin e realizimit të vlerësimit ka qenë i emëruar në pozicionin “Specialist i Shërbimeve”, në Nënprefekturën e Pukës.

- Për punonjësen *****, emëruar në pozicionin “Specialist i shërbimeve të deleguara”, në Sektorin Juridik dhe Funkcionet e Deleguara, nuk është kryer procedura e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik – Dhjetor 2015, për shkak të marrjes së lejes së lindjes.
- Për punonjësen *****, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme”, për periudhën Korrik – Dhjetor 2015 është dhënë vlerësimi “Jo kënaqshëm”. Ndaj këtij vlerësimi nëpunësja në fjalë ka qenë dakord dhe nuk ka kërkuar shqyrtim nga zyrtari autorizues. Në kushtet kur kjo nëpunëse ka marrë një vlerësim të tillë, institucioni i kontrolluar duhet të kishte garantuar për këtë punonjëse një trajnim të detyrueshëm dhe të kishte realizuar një rivlerësim 3 - mujor, kjo në kuptim të nenit 62, pika 2/1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Njëkohësisht u konstatua se, në momentin e mbikëqyrjes, formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor 2016, ishin plotësuar sipas afatit ligjor të përcaktuar në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar dhe ndodheshin në fazën e nënshkrimit nga Prefekti i Shkodrës, i cili në kuptim të ligjit firmos në cilësinë e zyrtarit autorizues.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, institucioni i kontrolluar i ka kryer procedurat e vlerësimit të rezultateve në punë sipas përcaktimeve të nenit 62, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, duke kryer vlerësimin sipas formatit të përcaktuar në Lidhjen nr. 1 të vendimit të sipërcituar.

Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së vlerësimit, apo në përfundim të periudhës së provës, rezulton të jetë miratuar nga nëpunësit e ngarkuar me kompetencën e vlerësimit, të cilët në zbatim të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, kanë plotësuar në mënyrën e duhur të gjitha elementët formale të kërkuara nga formulari i vlerësimit.

Nga vlerësimet e dhëna për nëpunësit e Administratës së Prefektit Shkodër, konstatohet se ata janë vlerësuar me nivele të ndryshme, si niveli 1 “Shumë mirë”, niveli 2 “Mirë” dhe niveli 4 “Jo kënaqshëm”. Pavarësisht vështirësisë për të matur nga jashtë saktësinë dhe efikasitetin e vlerësimeve të kryera nga personat kompetentë, kjo procedurë tregon për një qëndrim të kujdesshëm nga ana formale, në kryerjen e detyrës si nga njësi e personelit ashtu dhe nga ana e eprorëve direkt.

Për rregullimin e ligjshmërisë për të dy rastet e konstatuara në përmbajtje të raportit, njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, duhet të veprojë si më poshtë:

- Të kryejë procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik – Dhjetor 2015, për punonjësin *****, i cili në momentin e kryerjes së vlerësimit ka qenë i emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Kompetencave Vendore” dhe për punonjësin *****, i cili ka qenë i emëruar në pozicionin Specialist i Shërbimeve”, në Nënprefekturën e Pukës.

Duke qenë se vlerësimi i rezultateve në punë ka si synim verifikimin e realizimit të objektivave të nëpunësve si dhe të aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave dhe shërben për marrjen e vendimeve objektive në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirim nga shërbimi civil, përparimin në hapat e pagës si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil, sjellim në vëmendje të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore se, në rastet kur nëpunësit vlerësohen “Jo kënaqshëm”, institucioni ka detyrimin që të sigurojë për nëpunësit në fjalë një trajnim të detyrueshëm, kjo në zbatim të nenit 62, pika 2/1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në rastin e nëpunëses *****, e cila figuron që për periudhën Korrik – Dhjetor 2015, është vlerësuar me nivelin 4, “Jo kënaqshëm”, si dhe për rastet e mundshme në të ardhmen, institucioni i mbikëqyrur duhet të zbatojë dispozitat e mësipërme ligjore, duke garantuar trajnimet e nevojshme, në kuadër të rritjes së aftësive profesionale të nëpunësve civilë.

VII. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin si dhe rastet e tjera të transferimit)

Kriteret bazë mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të transferimit të nëpunësit civil në një pozicion tjetër të shërbimit civil (*transferim i përkohshëm, arsyet e transferimit, kohëzgjatja e transferimit, transferimi i përhershëm, rastet kur zbatohet transferimi i përhershëm, transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*), janë përcaktimet e Kreut VIII, “Transferimi në shërbimin civil”, dispozitat ligjore nga neni 48 deri në nenin 52, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimi nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe Udhëzimi nr. 1, datë 01.03.2016, i Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

Gjatë procesit të verifikimit në administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër, u konstatua se, për periudhën objekt mbikëqyrje në institucionin e kontrolluar është zbatuar vetëm rasti i transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit i parashikuar në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ndërsa, transferimi i përkohshëm; transferimi i përhershëm për arsye të paaftësisë shëndetësore; transferimi i përhershëm për shmangien e konfliktit të interesit dhe transferimi në përfundim të afatit apo të zhdukjes së shkakut të pezullimit për shkak të plotësimit përfundimtar të pozicionit të mëparshëm të punës, transferime këto të përcaktuara në nenet 48, 51, 52 dhe neni 56/1 të ligjit të sipërcituar, nuk janë zbatuar në asnjë rast për periudhën e mbikëqyrur.

- **Transferimi për shkak të ristrukturimit të Administratës së Prefektit Shkodër (apo ndryshimit të mënyrës së organizimit të institucionit)**

Nga verifikimi i tërësisë së materialeve shkresore të vëna në dispozicion, si dhe vlerësimit të tyre në raport me ligjin u vërejt se:

Me urdhrin nr. 11, datë 12.02.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër”, është miratuar struktura dhe organika e re e institucionit. Në pikën 3 të këtij urdhri është përcaktuar numri i punonjësve të administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër, gjithsej 27 veta. Gjithashtu, urdhri për miratimin e strukturës së re, ka shfuqizuar strukturën dhe organikën e vjetër të institucionit, të miratuar me urdhrin nr. 61, datë 10.04.2006 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Prefektit të Qarkut Shkodër”.

Nga krahasimi i strukturës dhe organikës së vjetër me strukturën dhe organikën e re, konstatohet se, sipas strukturës dhe organikës së vjetër, administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër kishte gjithsej 32 pozicione pune, ku sipas natyrës së funksioneve që kryenin: 3 pozicione ishin funksionarë politikë, (Prefekt + Nënprefekt i Malësisë së Madhe + Nënprefekt i Pukës); 3 pozicione pune ishin të Zyrës së Gjendjes Civile; 6 pozicione kryenin funksione administrative, (sekretar i prefektit + 4shofer + 1 punonjës pastrimi), dhe **20 pozicione pune ishin pozicione të shërbimit civil.**

Struktura dhe organika e re, ka parashikuar 27 pozicione pune, ku 3 janë funksionarë politikë, (prefekt + 2 nënprefekt), 3 pozicione pune kryejnë funksione administrative, (1 sekretar + 1 shofer + 1 punonjës pastrimi) dhe **21 pozicione pune janë pozicione të shërbimit civil.**

Mënyra e organizimit të pozicioneve të shërbimit civil sipas strukturës së re, krahasuar me strukturën e vjetër paraqitet si më poshtë:

Pozicionet e shërbimit civil sipas emërtesës	Numri i pozicioneve të punës (sipas strukturës së vjetër)	Numri i pozicioneve të punës (sipas strukturës së re)
Sekretar i Përgjithshëm	1	1
Përgjegjës Sektori	4	5
Përgjegjës Zyre	1	-
Specialist	14	15
Nëpunës civilë gjithsej	20	21

Sa më sipër, konstatohet se, në kuadër të ristrukturimit, Administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër ka kaluar në proces riorganizimi, për arsye se:

- Është shtuar 1 pozicion i shërbimit civil, (struktura e vjetër kishte 20 pozicione të shërbimit civil, ndërsa struktura e re ka 21 pozicione të shërbimit civil)
- Njësitë organizative pjesë përbërëse të institucionit, sektorët janë riorganizuar, pasi në strukturë është një sektor (struktura e re ka 5 sektorë nga 4 sektorë që kishte struktura e vjetër), si dhe në strukturën e re nuk ka njësi organizative me emërtesën “Zyrë”.

- Organika e re nuk ka më pozicione pune me emërtesën “Inspektor”, (ndërsa sipas strukturës së vjetër në organigramë ishin 3 pozicione pune me emërtesën “Inspektor”); pozicioni i punës “Sekretar i Përgjithshëm”, është kategorizuar në nivelin e pagës III-a, pozicionet “Përgjegjës Sektori” janë të kategorizuar në nivelin e pagës III-b dhe pozicionet “Specialist” në nivelin IV-b.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, miratimi i strukturës së re për Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër, është shoqëruar me ristrukturim të institucionit pasi ka shtim të pozicioneve të punës dhe riorganizim të strukturave organizative (të sektorëve).

- **Procedurat e ndjekura për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit.**

Për të verifikuar ligjshmërinë e procedurave të ndjekura nga institucioni i kontrolluar në kuadër të ristrukturimit, u kërkua dokumentacioni përkatës, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi se:

Pas hyrjes në fuqi të strukturës dhe organikës së re, Prefekti i Qarkut Shkodër i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike (DAP), me shkresën nr. 38/1 prot., datë 15.01.2016, nëpërmjet të cilës ka kërkuar nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit për administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me urdhrin nr. 168, datë 21.01.2016, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Prefektit të Qarkut Shkodër”, ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit të përbërë nga:

- **Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme**, që është dhe ministria nga e cila varet institucioni i prefektit, (***** me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me autorizimin nr. 304 prot., datë 18.01.2016, i ka deleguar të drejtën e përfaqësimit të tij në komisionet e ristrukturimit të ngritur pranë institucionit të Qarkut dhe Nënprefektit ***** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit me Prefekturat).
- **Një përfaqësues i njësisë përgjegjëse, (DAP-it)**, si kryetar i komisionit (***** me detyrë specialist në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Politikave të Rekrutimit të Administratës Publike, në DAP).
- **Nëpunësi më i lartë civil i institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër**, që është institucioni që i nënshtrohet procedurës së ristrukturimit. (***** Sekretar i Përgjithshëm në administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër – njoftuar DAP me shkresën nr. 38/3 prot., datë 21.02.2016 të Prefektit të Qarkut Shkodër).

Në kuadër të sistemimit të 20 nëpunësve civilë, për shkak të ndryshimeve të përshkrimeve të pozicionit të mëparshëm të punës, Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar mundësinë e sistemit të tyre në vendet e lira ekzistuese. Për këtë arsye, janë krahasuar përshkrimet e punës të nëpunësve me përshkrimet e punës të vendeve të lira, kriteret specifike të vendeve të lira të

krijua si dhe përputhshmërinë e tyre me kriteret që plotësojnë nëpunësit pozicionet e të cilëve kanë kaluar në proces ristrukturimi.

Pas kryerjes së këtyre procedurave, Prefekti i Qarkut Shkodër, për nëpunësit e prekur nga ristrukturimi, ka propozuar me shkrim dhe në mënyrë individuale transferimin e tyre në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotësonte kërkesat specifike për pozicionin përkatës. Ky propozim, i është përcjellë njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, me shkresën nr. 38/5 prot, datë 02.02.2016.

Ndaj kësaj praktike, Departamenti i Administratës Publike, duke konstatuar disa parregullsi ligjore të dukshme, me shkresën nr. 517/1 prot., datë 23.02.2016, ka kthyer përgjigje duke evidentuar këto parregullsi dhe duke kërkuar ndreqjen e tyre, për rastet si më poshtë:

- Për punonjësin *****, emëruar në pozicionin “*Specialist i rendit dhe emergjencave civile*”, në Sektorin Juridik dhe Funksioneve të Deleguara, Komisioni i Ristrukturimit ka kërkuar transferimin e tij në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të emergjencave e Krizave*”, nëpërmjet ngritjes në detyrë. Departamenti i Administratës Publike, në përgjigjen e tij, është shprehur se ky transferim nuk është i mundur, pasi në zbatim të nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, nëpunësi civil transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.
- Për punonjësen *****, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme*”, Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar transferimin e saj në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Departamenti i Administratës Publike, në shkresën e sipërcituar është shprehur se ky transferim nuk mund të bëhet, për shkak të përcaktimeve ligjore të nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, sipas të cilit transferimi i nëpunësit civil duhet të bëhet në të njëjtën kategori. Pavarësisht këtij qëndrimi, në bazë të deklaratës nr. 38/7 prot, datë 15.02.2016, në të cilën kjo nëpunëse ka shprehur vullnetin e saj për të kaluar në një pozicion të nivelit ekzekutiv, Departamenti i Administratës Publike, në përfundim të procedurës së ristrukturimit ka miratuar kalimin e saj në këtë pozicion.
- Për punonjësit *****, emëruar në pozicionin “*Specialist i emergjencave civile*”, në Nënprefekturën e Malësisë së Madhe dhe *****, emëruar në pozicionin “*Specialist i emergjencave civile*”, në Nënprefekturën e Pukës, Komisioni i Ristrukturimit ka kërkuar transferimin e tyre në pozicionet “*Specialist*”, në Sektorin e Planifikimit, Përballimit të emergjencave e Krizave. Departamenti i Administratës Publike ka refuzuar transferimin e tyre në këto pozicione të lira, me arsyen se këta punonjës nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, pasi me shkresën nr. 3285, datë 30.10.2014, “*Verifikim i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktual*”, është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit, (Konkretisht për punonjësen *****, është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit për shkak se ajo është emëruar pa procedurë të hapur konkurrimi, në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe për punonjësin *****, është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit për shkak të

mospërbushjes së kriterit arsimor për pozicionin punës). Ky fakt, tregon se nga institucioni i mbikëqyrur nuk është kryer ndërprerja e marrëdhënies së punësimit menjëherë pas përfundimit të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, sipas nenit 67, të ligjit të sipërcituar, por se këta punonjës kanë vazhduar të kryejnë detyrat në pozicione të shërbimit civil, pa gëzuar statusin e nëpunësit civil.

- Për punonjësen ******, emëruar në pozicionin “Sekretare”, Komisioni i Ristrukturimit ka kërkuar transferimin e saj në pozicionin “Specialist e arkiv protokollit”, në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Departamenti i Administratës Publike, ka refuzuar transferimin e kësaj punonjëse me arsyen se ajo ushtron detyra në një pozicion i cili nuk klasifikohet si pjesë e shërbimit civil dhe si rrjedhim ajo nuk gëzon statusin e nëpunësi civil.

Komisioni i Ristrukturimit, pas kthimit të akteve nga Departamenti i Administratës Publike, për shkak të parregullsive të konstatuara, ka shqyrtuar dhe ridërguar propozimet në DAP, ku ky i fundit me shkresën nr. 714/4, datë 12.04.2016, “*Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit në Institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër*”, ka vendosur për transferimin e nëpunësve civilë në pozicionet e tjera të shërbimit civil brenda institucionit, sipas strukturës së re të Administratës së Prefektit Shkodër. Vendimet individuale të transferimit i janë njoftuar çdo nëpunësi të prekur nga ristrukturimi dhe janë administruar në dosjet e personelit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë mbikëqyrjes, rezulton se në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit, pozicionet e gjendjes civile janë trajtuar si funksione të deleguara, por përpos këtij qëndrimi, Departamenti i Administratës Publike, ka konkluduar procedurën e ristrukturimit, duke nxjerrë aktet individuale të transferimit të përhershëm dhe për punonjësit të cilët ushtronin detyrën në pozicionet e gjendjes civile. Bëhet fjalë për punonjësen ******, me detyrë “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile” dhe punonjësen ******, me detyrë “Specialist i zyrës së gjendjes civile”, në Rrethin Pukë.

Konkluzion: Për sa është analizuar më sipër, Komisioneri vlerëson se:

- Ngritja e Komisionit të Ristrukturimit dhe procedurat e kryera për transferimin e nëpunësve civilë, për shkak të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, janë bërë në përputhje me përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe parashikimet e Kreut III, të vendimit 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, (shfuqizuar- akt nënligjor i cili ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të procedurës së ristrukturimit të institucionit) si dhe në respektim të procedurave të Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit*”, (shfuqizuar, udhëzim i cili ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të procedurës së ristrukturimit).
- Nëpunësit civil, pozicionet e të cilëve pësuan ndryshim për shkak të ristrukturimit, u transferuan në pozicione të tjera të shërbimit civil, të së njëjtën kategori, brenda

institucionit, duke marrë në konsideratë kriteret specifike të pozicioneve të reja si dhe përputhshmërinë e tyre me kriteret e nëpunësve.

- Departamenti i Administratës Publike, me të drejtë ka refuzuar propozimin e Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e punonjësve ***** dhe *****, për të cilët pas përfundimit të procesit të deklarimit të statusit të punësimit, ju është refuzuar statusi i nëpunësit civil. Propozimi i Komisionit të Ristrukturimit ka ardhur si pasojë e parregullsive të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër, e cila në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të kishte ndërprerë marrëdhënien e punësimit për këta punonjës në mënyrë të menjëhershme.
- Nëpunësit civilë të përfshirë në ristrukturim, në asnjë rast nuk e kanë refuzuar vendimin përfundimtar të transferimit në kuadër të ristrukturimit.
- Për sa është arsyetuar në rubrikën I/iv, “Konstatim”, të raportit, Komisioneri vlerëson se, aktet individuale të transferimit për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile, janë akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në kuptim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, janë akte absolutisht të pavlefshme, të cilat nuk sjellin asnjë pasojë juridike, pavarësisht nëse ato janë konstatuar si të tilla apo jo.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 111 dhe 113, pika 1, të Kodit të Procedurës Administrative, duhet të marrë masa për rregullimin e paligjshmërisë së këtyre akteve administrative, duke vepruar si më poshtë:

- Të anulojë aktin nr. 517/22, datë 12.04.2016, “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, për punonjësen *****, me detyrë “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër;
- Të anulojë aktin nr. 517/23, datë 12.04.2016, “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, për punonjësen *****, me detyrë “Specialist i zyrës së gjendjes civile”, për Rrethin Pukë, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër.
- Për pozicionet “Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave”, “Specialist, në Sektorin e Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave” dhe “Përgjegjës i Sektorit të Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse”, të cilët në përfundim të procedurës së transferimit të përhershëm të nëpunësve për shkak të ristrukturimit të administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër, rezultojnë pozicione të lira, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të këtij institucioni duhet t’i përfshijë ato në planin vjetor të rekrutimit për shërbimin civil për vitin 2017, duke ja njoftuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, në varësi të të cilës është, si dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse.

(Të dhënat që pasqyrojnë realizimin e procedurës së transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit të institucionit të Administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër janë të pasqyruara në mënyrë analitike në Aneksin nr. 2, të hartuar nga grupi i punës dhe që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij).

VIII. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm)

Instituti i disiplinës në shërbimin civil rregullohet në mënyrë të hollësishme në Kreun X, “Disiplina në shërbimin civil”, nga nenet 57 deri 61, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këtë kapitull përcaktohen në mënyrë specifike përgjegjësia për masat disiplinore, llojet e masave disiplinore; kompetencat dhe procedura për masat disiplinore; parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore dhe shuarja e masës disiplinore.

Në zbatim të këtyre dispozitave, në vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil” si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesore procedurale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, janë përcaktuar procedurat e hollësishme dhe të gjitha masat që duhet të ndërmerren nga personat kompetentë për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Në kuadër të drejtimeve të mbikëqyrjes, pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me praktikat e masave disiplinore, që janë aplikuar në administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër, u konstatua se për 2 (dy) nëpunës civilë janë dhënë masa disiplinore, të cilat paraqiten si më poshtë:

- Punonjësi *****, i cili në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka qenë i emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Administrimit Financiar” dhe për të cilin me aktin nr. 3285/3, datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil”. Me urdhrin nr. 72, datë 05.11.2015, të Prefektit të Qarkut Shkodër, “Për dhënie të masës disiplinore ndaj nëpunësve të administratës së Prefektit” është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”.
- Punonjësja *****, e cila në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka qenë e emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme” dhe për të cilën me aktin nr. 3285/ 5, datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”. Pas përfundimit të periudhës së provës, me vendimin nr. 1052/2, datë 01.06.2015, të Prefektit është vendosur konfirmimi si nëpunës civil. Me urdhrin nr. 72, datë 05.11.2015, të Prefektit të Qarkut Shkodër, “Për dhënie të masës disiplinore ndaj nëpunësve të administratës së Prefektit” është dhënë masa disiplinore

“Vërejtje”. Njëkohësisht, për këtë punonjëse, me urdhrin nr. 9, datë 09.02.2016, të Prefektit të Qarkut Shkodër është dhënë sërish masa disiplinore “Vërejtje”.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, aktet për dhënien e masës disiplinore ndaj nëpunësve, si më sipër, kanë dalë duke mos respektuar asnjë nga rregullat dhe procedurat e hollësishme të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët proceduralë dhe materialë të ecurisë disiplinore dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Ligji i posaçëm dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, në rastin e konstatimit të shkeljeve disiplinore përcaktojnë procedurat e hollësishme të cilat duhet të ndiqen nga personat kompetentë të ngarkuar nga ligji për fillimin e ecurisë disiplinore. Për shkelje të lehta, për të cilat neni 58 dhe 60, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikon masën disiplinore “Vërejtje”, eprori direkt, pas konstatimit të shkeljes disiplinore dhe vlerësimit paraprak merr vendim për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit në ngarkim dhe njofton këtë të fundit jo më vonë se 2 ditë pune nga marrja e vendimit për fillimin e ecurisë disiplinore.

Në kuptim të nenit 59, pika 7 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar procedimi disiplinor duhet të garantojë të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar në lidhje me fillimin e procedimit, për t’u informuar për shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Në mënyrë më të detajuar, në nenin 13, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” si dhe në Kreun “Organet disiplinore”, pika 1/b, të udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për elementët proceduralë dhe materialë të ecurisë disiplinore dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, njoftimi për fillimin e procedurës disiplinore duhet të përmbajë njëkohësisht datën dhe vendin ku do të shqyrtohet shkelja e pretenduar.

Nga tërësia e akteve që materializojnë veprimet e kryera për marrjen e masës disiplinore për të dy punonjësit si më sipër, u konstatua se administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër nuk ka respektuar procedurën për fillimin e ecurisë disiplinore, të përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Mos respektimi i kësaj procedure, përcakton se aktet me të cilat është marrë masë disiplinore “Vërejtje”, për punonjësit ***** dhe *****, janë akte absolutisht të pavlefshme në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, si akte të nxjerra në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligj.

Në kuptim të Kreut I, neni 1, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, organet disiplinore përgjegjëse për kryerjen e procedurës disiplinore janë Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes për anëtarët e TND-së

(KKP), komisioni disiplinor (KD) dhe eprori direkt, ku ky i fundit, për shkeljet e lehta, është organi kompetent për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”.

Ligji i posaçëm për shërbimin civil, në nenin 4, pika 1/e, përcakton se në cilësinë e eprorit direkt mund të jetë: i) *Titullari i institucionit për nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese, përfshirë nëpunësit në pozicionet e koordinatorit të posaçëm dhe drejtuesit e institucionit të varësisë; ii) Sekretari i përgjithshëm apo nëpunësi në pozicionin ekuivalent me të, për drejtorët e drejtorive dhe drejtuesit e degëve territoriale të institucionit; iii) Titullari i institucionit të varësisë për drejtorët brenda këtij institucioni ose iv) Drejtori i drejtorisë për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të tjera.*

Në lidhje me sa më sipër, nisur nga fakti që në strukturën e administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër nuk janë parashikuar pozicione të nivelit të mesëm drejtues, Komisioneri vlerëson se nuk mund të shprehet në lidhje me ligjshmërinë e akteve të nxjerra nga Prefekti, për marrjen e masës disiplinore.

Ligjshmëria e akteve të nxjerra nga Prefekti në cilësinë e eprorit direkt, do të zgjidhet përfundimisht pas qëndrimit të Departamentit të Administratës Publike në lidhje me unifikimin dhe ekuivalentimin e pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Prefekturës, përcaktimit të rolit të tij në hierarkinë e shërbimit civil.

Konkluzion: Komisioneri konkludon se masat disiplinore të dhëna ndaj nëpunësve civilë ***** dhe *****, janë marrë pa respektuar procedurën e përcaktuar në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët proceduralë dhe materialë të ecurisë disiplinore dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”. Mosrespektimi i procedurës së përcaktuar në dispozitat ligjore të mësipërme, përcakton pavlefshmërinë absolute të tyre.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrrur, duhet të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore për masat e marra ndaj nëpunësve ***** dhe *****, duke u kujdesur që në zbatim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të mësipërme, për shkak të mos respektimit të procedurës së përcaktuar në dispozitat ligjore të mësipërme.

Për ndreqjen e këtyre parregullsive, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër duhet të kryejë veprimet si më poshtë:

- Anulimin e pjesëshëm të urdhrit nr. 72, datë 05.11.2015, të Prefektit të Qarkut Shkodër, në pjesën ku është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, për nëpunësit ***** dhe *****.

- Anulimin e urdhrimit nr. 9, datë 09.02.2016, të Prefektit të Qarkut Shkodër, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për nëpunësen *****.
- Fshirjen e masave disiplinore për nëpunësit ***** dhe ***** nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës dhe më tej, të veprojë sipas orientimeve të dhëna si më sipër.

IX. Organizimi i Dosjes dhe Regjistrimit të Personelit

a. Dosja e personelit

Në zbatim të programit, u verifikuan dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe sipas kërkesave të vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit”.

Dosja e personelit është individuale dhe duhet të përmbajë të dhëna të karakterit teknik, profesionale, masat disiplinore, të dhënat për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë si dhe të dhëna të tjera sipas Lidhjes nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, lidhur me dosjet e personelit në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, u konstatua, se në çdo dosje janë të administruara dokumente që tregojnë për gjendjen civile (*certifikata të gjendjes familjare*); dokumente që vërtetojnë edukimin arsimor (*diploma e shkollës së lartë*); dokumente që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (*akti i emërimit*), akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (*certifikata kualifikimi*); aktet që provojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit si dhe aktet e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit të këtij institucioni.

Konstatohet se dosjet individuale të nëpunësve janë të sistemuara, ruhen në kushte të përshtatshme në ambientet e institucionit dhe administrohen nga specialisti i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në mungesë të Përgjegjës të Sektorit (*i cili është pozicion i lirë*), i cili është nëpunësi përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore në kuptim të Kreut I-rë, pika 4, të vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit”.

Nga verifikimi i dosjeve të personelit në disa raste u vërejtën mangësi të lidhura me mungesën e dokumentit të identifikimit (*fotokopje e pasaportës ose kartës së identitetit*); raportit mjekoligjor, si dhe të vërtetimit të gjendjes gjyqësore (*dëshmia e penalitetit*). Plotësimi i këtyre kërkesave është shprehur në mënyrë të detajuar në **Aneksin nr. 3**, që është pjesë e këtij raporti.

Përfshirja e këtyre akteve në dosjen individuale të nëpunësit civil kërkohet shprehimisht në Kreun I-rë, pika 3, si dhe në lidhjen 1 dhe 2 të aktit normativ të sipërcituar.

Nga grumbullimi i të dhënave konstatohet se në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, janë 21 pozicione pune të shërbimit civil, nga të cilat:

- ✓ 3 pozicione janë të lira;
- ✓ 18 pozicione të plotësuara.

Referuar të dhënave të mbledhura në bazë të dosjeve personale për 18 nëpunës civilë të institucionit të kontrolluar, të dhënat statistikore, paraqiten si më poshtë”:

- ✓ 12 Nëpunës civilë janë të gjinisë femërore;
- ✓ 6 Nëpunës civilë janë të gjinisë mashkullore;
- ✓ Mosha mesatare e femrave është afërsisht 36 vjeç;
- ✓ Mosha mesatare e meshkujve është afërsisht 59 vjeç;
- ✓ Mosha mesatare e numrit total të nëpunësve civil është 43 vjeç.

Njëkohësisht të gjithë nëpunësit civilë të institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër rezultojnë të kenë diplomë të studimeve të larta universitare, të marra nga Universitet Publike të Republikës së Shqipërisë.

Konkluzion: Për sa më sipër, Komisioneri rekomandon që dosjet e personelit të organizohen dhe plotësohen në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", duke bërë pjesë të saj të gjithë dokumentacionin që është konstatuar si mangësi në **Aneksin nr. 3**, "Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër", që është pjesë e këtij raporti.

Lidhur me plotësimin e kërkesave të posaçme për vendin e punës, nga nëpunësit që aktualisht janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, (lidhur me plotësimin e kërkesave për nivelin e diplomës, profilin e arsimit, eksperiencën në punë, kualifikimet, trajnimet, njohuri të gjuhës së huaj etj.), Komisioneri nuk mund të arrijë në një konkluzion pasi, siç është përmendur edhe më parë në këtë material, institucioni i kontrolluar nuk ka përshkrime të reja pune të miratuara sipas strukturës dhe organikës në fuqi, e cila është shoqëruar me mbyllje dhe ristrukturim të institucionit. Për këtë arsye, Komisioneri çmon se, verifikimi i këtyre akteve, do të jetë objekt i verifikimit të mëtejshëm, në vijim të procesit të mbikëqyrjes së kryer në këtë institucion.

b. Regjistri Qendror i Personelit

Regjistri Qendror i Personelit si sistemi që ruan dhe përpunon të dhënat elektronike për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, është krijuar dhe administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

Institucioni i mbikëqyrur ka akses në sistem dhe e ushtron këtë funksion nëpërmjet specialistit të personelit. Në sistem bëhet plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të parashikuara në lidhjen 3 "Përkufizimi i administruesve dhe përdoruesve të sistemit", që i bashkëlidhet vendimit nr. 117,

datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit të personelit”.

*
* *
*

Këto ish-in rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas objektit të tij, janë materializuar në tabelat e mëposhtme respektive për institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, të cilat janë pjesë e këtij raporti.

1. **Aneksi 1** - “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civilë, i ndryshuar, (data 26.02.2014)”;
2. **Aneksi 2** - “Aktet që materializojnë procesin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit të Prefektit të Qarkut Shkodër, (sipas strukturës së miratuar me urdhrin nr. 11, datë 12.01.2016, të Kryeministrit)”;
3. **Aneksi 3** - “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër”.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA